

Thirrje publike për aplikim për ngritjen e kapaciteteve dhe nën grantim për perspektivën gjinore në financimin për ndryshimet klimatike

Nr. i referencës i thirrjes: 2841/06/24

Projekti: FORCIMI I TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES PËR BARAZINË GJINORE NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE MOLDAVI (RRJETI MBIKËQYRËS I BUXHETIT GJINOR, FAZA II)

Financuar nga: Agjencia Austriake për Zhvillim dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar

Partnerët zbatues: Qendra për Hulumtim dhe Politikëbërje, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim; Qendra për Promovimin e Shoqërisë Civile; Rrjeti i Grave të Kosovës; Women Action; Gender Knowledge Hub; Keystone Moldova.

Rrjeti Mbikëqyrës i Buxhetit Gjinor (RrMBGj) shpall thirrjen publike për aplikim për ngritjen e kapaciteteve dhe nën grante për perspektivën gjinore në financimin për ndryshimet klimatike nga Rrjeti Mbikëqyrës i Buxhetit Gjinor nga **Maqedonia e Veriut, Serbia, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi dhe Moldavia.**

Rreth projektit

Qeveritë ende nuk i kanë përbushur plotësisht zotimet për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor (BPGj) dhe për të institucionalizuar BPGj-në gjatë gjithë procesit buxhetor. Përveç kësaj, analiza gjinore dhe qasja transformuese gjinore ndaj ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor (BP) dhe në Moldavi është e kufizuar. Ndërkohë, pavarësisht nga angazhimi i rritur i shoqërisë civile në çështjet gjinore dhe ato të ndryshimeve klimatike, ekzistojnë vetëm disa nisma ndërthurëse për barazinë gjinore dhe ndryshimet klimatike. OShC-ve dhe politikëbërësve ende u mungojnë njohuritë, metodologjitë dhe aftësitë në fushën e BPGj-së, veçanërisht në lidhje me financimin për adresimin e ndryshimeve klimatike dhe për reagimin ndaj tyre.

Objekti i përgjithshëm i projektit tonë të përbashkët është të përmirësojë zotimet publike për veprime të përgjegjshme gjinore ndaj ndryshimeve klimatike dhe të rrisë financimin e disponueshëm për zbatimin e veprimit të përgjegjshëm gjinor ndaj ndryshimeve klimatike në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Republikën e Moldavisë.

Rezultatet e parashikuara të **projektit** përfshijnë:

- Rritjen e mëtejshme të dukshmërisë dhe njohjes ndërkombëtare të punës së Rrjetit të Monitorimit të Buxhetimit Gjinor;
- Rritjen e kapaciteteve të OShC-ve për të përdorur mjetet e BPGj-së për mbikëqyrjen e politikave dhe financimit për adresimin e ndryshimeve klimatike;
- Përmirësimin e pjesëmarrjes së OShC-ve në proceset e politikave dhe buxhetimit përmes mbikëqyrjes së buxhetit gjinor;
- Përmirësimin e disponueshmërisë së mjeteve për rritjen e llogaridhënies së qeverisë, veçanërisht në reagimet ndaj ndryshimeve klimatike, burimet financiare për adresimin e ndryshimeve klimatike dhe përfshirjes së perspektivës gjinore në kornizën në politikat për ndryshimet klimatike

THIRRJE PËR APLIKIM

Si avokues për drejtësi dhe barazi sociale, është thelbësore që OShC-të të kenë njohuri për Buxhetimin e përgjigjshëm gjinor dhe si duhet ta zbatojnë atë qeveritë për të krijuar shoqëri më të barabarta. Prandaj, me këtë thirrje, ftojmë organizatat e shoqërisë civile nga BP dhe Moldavia të dorëzojnë një projekt ide (project concept note) për llojet e mëposhtme të granteve:

Grantet kombëtare – do të ndahen dy (2) grante për çdo vend, me një shumë maksimale prej 8,000 € për grant. Projektet duhet të përfundojnë brenda një periudhe deri në tetëmbëdhjetë muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Grantet rajonale - do të ndahen dy grante me shumën maksimale prej 25,000 € për grant. Projektet duhet të përfundojnë brenda një periudhe deri në njëzet e katër muaj. Gjithsej, do të ofrohen 16 grante (2 për vend dhe 2 rajonale) në kuadër të këtyre skemave të granteve.

Projektet duhet të lidhet me buxhetimin e përgjigjshëm gjinor dhe financimin për adresimin e ndryshimeve klimatike, duke përfshirë analizën gjinore për të informuar shpenzimet, monitorimin e shpenzimeve përmes analizës së ndikimit gjinor, ose duke përdorur mjete të tjera të BPGJ-së. Çështjet e mundshme në të cilat projektet mund të fokusohen mund të jenë, por jo domosdoshmërisht të kufizohen në:

- Çështjet gjinore në Fondin Global për Mjedisin (Gender in Global Environment Facility-GEF), Fondin e Gjellbër për Klimën (Green Climate Fund-GCF), Fondin e Vendeve më pak të Zhvilluara (Least Developed Countries Fund -LDCF) dhe Fondin e Veçantë për Ndryshimet Klimatike (Special Climate Change Fund-SCCF);
- Çështjet gjinore në projektet e 'gjelbra' të WBIF, EIB dhe BERZH;
- Çështjet gjinore në projektet për qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike, të mbështetura nga buxheti kombëtar;
- Çështjet gjinore në projektet për ndryshimet klimatike, të mbështetura nga buxheti lokal.

Pas përzgjedhjes, përfaqësuesit e secilës prej organizatave të përzgjedhura do të duhen t'i ndjekin modulet e trajnimit mbi buxhetimin e përgjigjshëm gjinor dhe financimin për adresimin e çështjeve gjinore dhe ndryshimeve klimatike, ku do të fitojnë njohuri në lidhje me mjetet e ndryshme të BPGJ-së. Më pas, këto njohuri duhet të përdoren për të zhvilluar një propozim të plotë të projektit me asistencë të përshtatur (mentorim) nga ekspertë në fushën e buxhetimit gjinor dhe të financimit të çështjeve të ndryshimeve klimatike, si dhe nga mentorë nga GBWN. Modulet e trajnimit mund të gjenden online në [GBWN e-academy](#) (Basic GRB dhe Advanced GRB), të krijuara posaçërisht për OShC-të. Trajnimi ballë për ballë mbi "Monitorimin e burimeve financiare për adresimin e ndryshimeve klimatike nga perspektiva gjinore" do të organizohet fizikisht në Shqipëri nga data 25 deri më 27 shtator 2024. Organizatat aplikuese do të duhet të emërojnë një përfaqësues për të ndjekur dhe përfunduar këto trajnime, duke specifikuar pjesëmarrësin e trajnimit në Shqipëri gjatë procesit të aplikimit. Pas ndjekjes së këtyre trajnimeve, organizatat do të ftohen të paraqesin propozimet e tyre të plota për financim.

KRITERET PËR PRANIMIN E APLIKUESVE

Mund të aplikojnë OShC të regjistruara ligjërisht nga shtatë vendet: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Mali i Zi dhe Serbia. Preferohet, por jo domosdoshmërisht, të jenë:

- Organizata për të drejtat e grave - organizata që punojnë për avancimin e të drejtave të grave, si dhe ato që kanë qasje ndërthurëse gjatë punës me gra të ndryshme, si gratë nga zonat rurale, gratë me aftësi të kufizuara, gratë e varfra dhe personat me orientime seksuale dhe identitete gjinore të ndryshme;
- Organizatat *think tank* - veçanërisht ato që punojnë për reformat përkatëse për anëtarësimin në BE në arsim, për rininë, administratën publike dhe financat publike, ndër të tjera;
- OShC-të që punojnë në fushën e financave publike (çështjet e buxhetit ose prokurimit) - që merren me financat publike, monitorimin e buxhetit dhe monitorimin e prokurimit publik;
- Organizatat për mbrojtjen e mjedisit - që merren me agjendat mjedisore;
- Organizatat e burrave – organizata aktive për çështjet e barazisë gjinore dhe çështjet e tjera me të cilat përballen burrat;
- Organizatat që punojnë në zbatimin e Rezolutës 1325 të OKB-së dhe agjendës për gratë, paqen dhe sigurinë.

Për t'u kualifikuar për një grant, aplikuesi kryesor dhe partnerët e tij duhet:

- të përfundojë modulet online të trajnimit dhe të marrë pjesë në trajnimin e tretë në Shqipëri me prani fizike (të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe trajnimit do të paguhen nga organizatorët),
- të jetë person juridik,
- të jetë nga organizata jofitimprurëse,
- të jetë nga organizata e regjistruar/krijuar të paktën dy vjet para publikimit të kësaj Thirrjeje, dhe
- të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit me partnerët e tij, duke mos vepruar si ndërmjetës,
- të jetë i gatshëm t'i nënshtrohet një Vlerësimi të Kapaciteteve Organizative dhe Avokuese në rast se përzgjidhet për grant, për të zhvilluar një Plan Zhvillimi të Kapacitetit bazuar në gjetjet e vlerësimit dhe të lidhura me projektin e propozuar, dhe për të punuar për zbatimin e tij si pjesë e projektit; dhe sa i përket granteve rajonale, të paktën 3 OShC nga 3 vende të ndryshme duhet të jenë pjesë e konsorciumit, dhe secila nga këto 3 OShC duhet të përmbushë kriteret e mësipërme të pranimit.

Numri i aplikimeve dhe granteve për aplikues

Aplikuesi kryesor nuk mund të dorëzojë më shumë se 1 aplikim sipas thirrjes kombëtare për aplikim.

Megjithatë, aplikuesi kryesor për një grant kombëtar mund të jetë partner në 1 aplikim tjetër të thirrjes rajonale në të njëjtën kohë.

Aplikuesit kryesor mund t'i ndahet më shumë se 1 grant sipas kësaj thirrjeje për aplikim (një herë sipas skemës kombëtare të granteve dhe herën e dytë si partner sipas skemës rajonale të granteve).

LISTA E DOKUMENTEVE TË KËRKUARA PËR FAZËN E APLIKIMIT ME PROJEKT IDE (CONCEPT NOTE)

Dokumentet e mëposhtme duhet të dorëzohen në fazën e projekt idesë (concept note)

- Formulari i plotësuar i aplikimit dhe concept note (Aneksi 1);
- Statuti i OShC-së dhe i çdo partneri të OShC-së (për grantet rajonale);
- Pasqyrat financiare për dy vitet e fundit;
- Dëshmia e regjistrimit

AFATI KOHOR

Aplikimi me concept note	Afati
Publikimi i kërkesës për aplikime	20 qershor
Sesioni informues (do të shpallet për secilin vend më vete) - Shqipëri - Bosnjë dhe Hercegovinë - Maqedonia e Veriut - Mali i Zi - Moldavia - Kosovë - Serbi	20 qershor – 1 korrik
Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit	1 gusht
Përfundimi i trajnimeve online në GBWN e-academy	1 gusht - 8 shtator
Njoftimi për përzgjedhjen e pjesëmarrësve në trajnimin ballë për ballë	10 shtator
Trajnimi mbi perspektivën gjinore në financimin për adresimin e ndryshimeve klimatike për OShC-të në Shqipëri	25 shtator – 27 shtator
Propozimet e plota të projekteve dhe buxhetit (shabllonet do të jepen pas përzgjedhjes së projekt ideve (concept notes))	18 tetor
Shpallja e përfituesve	25 tetor
Nënshkrimi i kontratës me përfituesit përfundimtarë dhe data e parashikuar e fillimit të projektit	1 nëntor

KRITERET PËR VLERËSIMIN E PROJEKT IDEVE (CONCEPT NOTES)

Si pjesë e vlerësimit administrativ, Konsorciumi rezervon të drejtën të verifikojë informacionin dhe dokumentet e dorëzuara nga aplikuesit, me ofruesit e autorizuar të këtyre shërbimeve dhe/ose institucionet shtetërore.

Projekt idetë do të vlerësohen sipas kriterëve të përcaktuara më poshtë. Projekt idetë do të marrin një notë të përgjithshme nga 30 pikë maksimale, përmes vlerësimit të detajuar më poshtë. Kriteret e vlerësimit janë të ndara në tituj dhe nëntituj. Çdo nëntitull do t'i jepen pikë mes 1 dhe 5 si më poshtë: 1 = shumë dobët; 2 = dobët; 3 = e pranueshme; 4 = mirë; 5 = shumë mirë.

KRITERET	Pikë	
1. Përshtatshmëria e projektit	Nën-pikë	10
1.1 Sa i përshtatshëm është koncepti me objektivin e thirrjes për propozime? Sa i përshtatshëm është koncepti me temat specifike të cekura në thirrje?	5	
1.2 Sa i përshtatshëm është projekti me nevojat e identifikuarat qartë të përfituesve përfundimtarë dhe grupeve të synuara, dhe a janë këto të zgjedhura në mënyrë strategjike dhe të përcaktuara në mënyrë të qartë?	5	
2. Hartimi i projektit	Nën-pikë	20
2.1 Sa koherent është hartimi i përgjithshëm i projektit? A i tregon koncepti rezultatet e pritura që do të arrihen nga projekti?	5x2	
2.2 Përvoja dhe kapacitetet e OShC-ve, duke përfshirë kapacitetet financiare	5	
2.3 Sa përfshihen grupe të ndryshme si grupe të synuara dhe/ose përfitues, duke përdorur qasjen ndërthurëse (p.sh., persona të moshave, gjinive, etnive, aftësive, feve, identiteteve, vendndodhjeve rurale/urbane të ndryshme si dhe grupe të marginalizuara)	5	
GJITHSEJ PIKË		30

DORËZIMI DHE AFATI

Formulari i plotësuar i aplikimit, projekt ideja dhe dokumentet duhet t'i dërgohen drejtpërdrejt Menaxheres për Mësim dhe Grante të GBWN - Liljana Tanevska Arsova në adresën e mëposhtme të e-mail: tanevska@crpm.org.mk jo më vonë se 1 gusht 2024 COB (në përfundim të ditës së punës).